



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samoupraveć
Ministry of Local Government Administration

Datë: 04.04.2013
Nr. 0204-360

PËR: Ramadan Muja, Kryetar i Komunës së Prizrenit
Nijazi Kryeziu, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prizrenit

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SË PRIZRENIT, Nr.01/011-2467, Pranuar me datë, 22.03.2013.

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit Nr.01/011-2467, të miratuar me datë 21.02.2013, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i listuar si në vijim, ka efekt të plotë juridik.

- Vendimi Nr.01/011-2467, për Themelimin dhe Emërimin e Komisionit Komunal për Vlerësimin e Ofertave për Dhënien e Pronës Komunale në Shfrytëzim.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL-së,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samoupraveć
Ministry of Local Government Administration

Datum: 04.04.2013
Br. 0204-360

Za: Ramadan Muja, Gradonačelnik Opštine Prizren
Nijazi Kryeziu, Predsedavajući Skupštine Opštine Prizren

PREDMET: POTVRDA ZAKONITOSTI ODLUKE OPŠTINE PRIZREN, br.01/011-2467, Priljeno dana, 22.03.2013.

Poštovani,

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandatom odredjenim po Zakonu za lokalnu samoupravu br. 03/L-040, dodatak XII Uredbe Vlade 02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, posle razmatranja Odluke Br.01/011-2467, usvojene dana 21.02.2013, **POTVRDJUJE** zakonitost ovog akta i ceni da je isti u skladu sa Zakonom za lokalnu samoupravu .

Pravni Akt naveden u nastavku, ima puni pravni efekat .

- Odluka br.01/011-2467 ,o osnivanju i imenovanju opštinske komisije za procenjivanje ponuda za davanje opštinske imovine na korišćenje.

S poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamanik premijera i Ministar MALS-a,

Kopija: Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a
Direktorima Uprava MALS-a
Arhivi MALS-a.

Në bazë të nenit 8 të Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme komunale, nenit 12 al.1 dhe nenit 51 al.2 të Ligjit për Vetëqeverisje lokale, nenit 27, al. 1 dhe nenit 58 al.2 të Statutit të Komunës së Prizrenit, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e vet të mbajtur më 21 shkurt 2013, miratoi këtë

V E N D I M
PËR THEMELIMIN DHE EMËRIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL PËR
VLERËSIMIN E OFERTAVE PËR DHËNIEN E PRONËS KOMUNALE NË
SHFRYTËZIM

Neni 1

Me këtë Vendim, themelohet Komisioni për vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim si dhe në këmbim të pronës komunale.

Për mandatin aktual, për anëtarë të këtij komisioni emërohen: Hasan Hasani, Sadik Paçarizi dhe Minir Krasniqi, nga radhët e ekzekutivit, 3 anëtarë do të emërohen nga Kuvendi dhe Bashkim Kajdomçaj, nga Shoqëria civile.

Neni 2

Nga mesi i anëtarëve të emëruar në këtë Komision, vetë anëtarët, në mbledhjen e parë do ta zgjedhin kryesuesin dhe zëvendëskryesuesin e Komisionit.

Neni 3

Kompetencat e Komisionit nga neni 1 i këtij Vendimi do të jenë: ato kompetenca të parapara me nenin 8 dhe 9 të Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme komunale.

Neni 4

Përbërja e Komisionit, sipas nevojës mund të zgjerohet me ekspertë të tjerë profesionalë, mirëpo ata nuk do të kenë të drejtë vote.

Për çdo pjesëmarrje në punën e këtij komisioni, anëtarët e komisionit të emëruar me këtë Vendim dhe ekspertët e ftuar në mbledhje të këtij Komisioni do të kompensohen në pajtim me dispozitat e Udhëzimit Administrativ të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës për pagesën e stafit politik në komuna nr. 16/2008.

Neni 5

Për punën e Komisionit dhe të çështjeve të tjera me rëndësi, do të mbahet procesverbali.

Neni 6

Për punët administrative-teknike dhe çështjet e tjera profesionale lidhur me punën e Komisionit, është përgjegjës Shërbimi i Pronës.

Neni 7

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: kryetari i Komunës, kryesuesi i Komisionit dhe Shërbimi i Pronës..

Neni 8

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit dhe do të shpallet në Web faqen e Komunës.

KOMUNA E PRIZRENIT
Kuvendi i Komunës
Nr.01/011-2467
Më 21 shkurt 2013
Prizren



Kryesuesi i Kuvendit
Nijazi Kryeziu